

URDHËR
Nr. 328, datë 26.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 85, DATË 17.2.2023, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES, ‘PËR KONTROLLIN ZYRTAR MBI PËRDORIMIN
E SUBSTANCAVE FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË AUTORIZUARA SI
PRODUKTE MJEKËSORE VETERINARE OSE SI ADITIVË PËR USHQIMET PËR
KAFSHË DHE MBETJET E TYRE, SI DHE MBI PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE
FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË NDALUARA, QË PËRDOREN NË KAFSHËT
QË PRODHONJË USHQIM DHE MBETJET E TYRE, PËR ZBATIMIN E PKMM-së
1”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës; pikës 3, të nenit 81, pikës 8, të nenit 102, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në rregulloren bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të urdhrit nr. 85, datë 17.2.2023, “Për miratim e rregullores, ‘Për kontrollin zyrtar mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si produkte mjekësore veterinar ose si aditivë për ushqimet për kafshë dhe mbetjet e tyre, si dhe mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara, që përdoren në kafshët që prodhojnë ushqim dhe mbetjet e tyre, për zbatimin e PKMM”” bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në aneksin I, grupi A, pika 2 shprehja:

“Në tabelën 2, të aneksit të urdhrit nr. 139/1, datë 7.4.2017, “Për substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre, në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore””, zëvendësohet me shprehjen “në tabelën 2, të shtojcës 1, të urdhrit nr. 991, datë 13.10.2025, “Mbi substancat farmakologjikisht aktive dhe klasifikimin e tyre në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore””,

2. Në aneksin I, grupi A, pika 3 dhe në grupin B pika 1, shprehja:

“Në tabelën 1, të aneksit të urdhrit nr. 139/1, datë 7.4.2017, “Për substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre, në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore””, zëvendësohet me shprehjen “në tabelën I, të shtojcës I, të urdhrit nr. 991, datë 13.10.2025, “Mbi substancat farmakologjikisht aktive dhe klasifikimin e tyre në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore””,

3. Në aneksin II, shkronja A, tabela që përbën pikën 1, zëvendësohet me tabelën si më poshtë:

	Grupet e produkteve
--	---------------------

¹ Ky urdhër përafuron rregulloren e deleguar (BE) 2024/2562 të Komisionit, datë 3 qershor 2024 e cila ndryshon rregulloren (BE) 2022/1644, të Komisionit Evropian e miratuar me urdhrin nr. 85, datë 9.3.2023, “Për kontrollin zyrtar mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si produkte mjekësore veterinar ose si aditivë për ushqimet për kafshë dhe mbetjet e tyre, si dhe mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara, që përdoren në kafshët që prodhojnë ushqim dhe mbetjet e tyre, për zbatimin e PKMM-së”.

Grupet e substancave sipas përshkrimeve të aneksit I	Gjedhët, dhenët, dhinë	Derra	Njëthundrakë	Pula	Akuakultura (peshku, fin fish) krostace dhe produkte të tjera të akuakulturës	Qumësht i freskët i gjedhët dhe dhinë	Vezë pule dhe vezë të tjera	Lepuri, kafshë të egra të mbarështuara, reptilë dhe insekte	Mjalti	Zorrë
Grupi A 1, germa “a”	X	X						X		
Grupi A 1, germa “b”	X	X	X					X		
Grupi A 1, germa “c”	X	X	X		X ⁽¹⁾			X		
Grupi A 1, germa “d”	X	X						X		
Grupi A 1, germa “e”	X	X	X	X				X		
Grupi A 2	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Grupi A 3, germa “a”					X					
Grupi A 3, germa “b”	X	X	X	X	X		X	X		
Grupi A 3, germa “c”	X	X	X	X	X	X	X	X	X	
Grupi A 3, germa “d”	X	X		X			X	X		
Grupi A 3, germa “e”										
Grupi A 3, germa “f”	X	X	X	X		X		X	X	
Grupi A 3, germa “g”										

(1) E vlefshme vetëm për peshqit

4. Në aneksin II, shkronja B, në nënpikën “vii”, të pikës 1, shprehja:

“Urdhri nr. 139/1, datë 7.4.2017, “Për substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre, në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore”, zëvendësohet me shprehjen “Urdhri nr. 991, datë 13.10.2025, “Mbi substancat farmakologjike aktive dhe klasifikimin e tyre, në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore”,”.

5. Përmbytja e aneksit IV të rregullores, ndryshon si më poshtë:

“Kriteret për përzgjedhjen e kombinimeve specifike të grupeve të substancave dhe grupeve të produkteve për hartimin e planit kombëtar të mbikëqyrjes së rastësishme, sipas kërkesave të pikës 3, nenin 2 të kësaj rregulloreje

Substanca të grupit A

Kampionet e përbëra nga kombinime të grupeve të substancave dhe grupe të produkteve janë të ndryshme nga kampionet e marra në zbatim të planeve kombëtare të prodhimit të bazuara në risk.

Substanca të grupit B

Kombinimet e grupeve të substancave dhe grupeve të produkteve:

Grupet e substancave	Gjedhë, dhen dhe dhinë	Derra	Njëthundrakë	Pula	Akuakultura (peshku, krostace, produkte të tjera të akuakulturës)	Qumësht i freskët nga gjedhët, dhenët dhe dhinë	Vezë pule dhe vezë të tjera	Lepuri, kafshë të egra të mbarështuara, reptilë dhe insekte	Mjaltë
B1a	X	X	X	X	X	X	X	X	X
B1b	X	X	X	X	X	X	X	X	X
B1c	X	X	X					X	
B1d	X	X	X	X		X		X	
B1e									
B2	X	X	X	X			X	X	

Çdo kampion për një lloj të caktuar kafshe ose produkti specifik analizohet duke përfshirë një numër sa më të madh të mundshëm të substancave, në grupet e listuara në tabelën e përfshirë në këtë aneks.

Duhet të sigurohet që për një lloj të caktuar kafshe ose produkt të caktuar, plani iurvejancës të përfshijë të gjitha grupet e substancave të listuara në tabelë. Kontrollat kryhen për sa më shumë substanca farmakologjike aktive që të jetë e mundur, për të cilat kufijtë maksimalë të

mbetjeve janë përcaktuar në shtojcën I, të urdhrit. nr. 991, datë 13.10.2025, “Mbi substancat farmakologjikisht aktive dhe klasifikimin e tyre, në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore” dhe legjislacionit mbi aditivët për përdorim në ushqimin e kafshëve.”.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla